



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), dispozitave të **nenit 8**, të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndër-Komunal, nenit 5 të Rregullores nr. 09/2013 për nxitjen e bashkëpunimit ndër-komunal, dhe dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 24.4.2024, miraton këtë:

V E N D I M

- 1. Miratohet** Vendimi për marrëveshje-kornizë të bashkëpunimit ndër-komunal shumë-funksional ndërmjet: Kryeqytetit të Republikës së Kosovës - Prishtinës, Komunës së Podujevës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Fushë Kosovës, Komunës së Graçanicës dhe Komunës së Obiliqit.
- 2. Qëllimi** i kësaj Marrëveshjeje të Bashkëpunimit është bashkërendimi i aktiviteteve në mes të Kryeqytetit dhe pesë (5) komunave fqinje, në fusha të ndryshme me interes të përgjithshëm, me të cilin do të krijohen lehtësira për mirëqenien e qytetarëve të Kryeqytetit dhe këtyre komunave në sfera të ndryshme të jetës.
- 3. Për realizimin** e këtyre marrëveshjeve do të kujdeset Kryetari i Kryeqytetit.
- 4. Ky vendim** hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-024/01-54377/24, më 26.4.2024

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupisa

